



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY



Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 pika 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e dymbëdhjet të rregullt të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më datë: **26.12.2019** (e enjte) duke filluar në ora **10:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Aprovimi i Raportit Financiar për tremujorin e tretë Korrik-Shtator 2019;
3. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ne lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 16.12.2019
Në: Novobërdë



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit

(Signature)



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e njëmbëdhjetë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 27.11.2019, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, anëtarët e Kuvendit: Predrag Stojkovic, Ivica Cenic, Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhju, Dobrivoje Djordjevic, Xhejlane Behluli, Zymer Zymeri, Jahi Zeqiri, Nënkyetari për Komunitete Bajrush Ymeri, Drejtori i Administrates Driton Abdyli, Shefja e ZKKK Jasmina Denic, ZKKK Sami Vllasaliu, Menaxheri i EccoHigienes Naser Ibrahim, përfaqësuesi i OSBE-es, zyrtar komunal dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshendeti të pranishmit tha: para se të fillojmë me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë të gjithë antarët të Kuvendit, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojmë mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Aprovimi i planit Aksional për të riatdhesuarit;
3. Aprovimi i planit Aksional për Kthim të qëndrueshëm;
4. Prerja e Vendimit për shitjen e automjeteve të vjetra të në gjendje teknike jo të regullt, në bazë të propozimit nga komisioni për vlerësimin e gjendjes së Automjeteve të Komunës;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti antarët e Kuvendit se a pajtoheni me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Aprovohet rendi i ditës nga të gjithë antarët e Kuvendit me 13 vota për dhe 2 nuk kanë votuar.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti pasi përshendeti të pranishmit tha: unë dua të shtoj te procesverbali i seances së kaluar një reagim që kam thënë edhe më herët disa herë, ne seancen e kaluar kemi pasur një polemik të vogël me kolegen Xhejlane Behluli, unë kam thënë kështu se me 31.05.2018 e kemi vendimin që u marrë në Kuvend për bartjen e mjeteve nga kodi i ujësjellsave në kodin për ndriqime publike vlera 30,000€, procesverbali i seances se muajit të pestë e vitit 2018, pika e dytë pruarja e vendimit për transferin e mjeteve të investimeve kapitale nga kodi i ujësjellsave në kodin e ndriqimit publik, në procesverbal më tutje thuhet kështu antari i Kuvendit Xhevat Mehmeti kerkon nga Kryetari i Komunës pasi që në vitin e kaluar ka premtuar në fshatin Pasjak ndriqimin dhe thotë se unë propozoj që këto mjete të shkojnë në ndriqim në fshatin Pasjak dhe kerkon që të aprovohet nga Kuvendi kjo pikë, mos ta lexoj të gjithë procesverbalin por më pastaj zv.Kryesuesi Bajrush Ymeri thotë se pajtohem plotësisht dhe kerkoj që pjesen e mbetur të mjeteve kerkoj që të vazhdohet ndriqimi në fshatin Llabjan dhe Kuvendi me 13 vota për e aprovon këtë

Procesverbali i Kuvendit

vendim e kjo do të thotë se unë nuk kam genjyer asnjëher por kam thënë atë dhe do e them perseri se Kuvendi ka marrë një vendim që qytetarëve të fshatit Pasjak të ju ndërtohet ndriqimi publik dhe vlera e projektit ka qenë 30.000€, prandaj reagoja pasi që u permend disa herë në mbledhjen e kaluar por unë po e them të verteten në bazë të vendimit, ju faleminderit.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: fjala genjej nuk është permend vetem kamë thënë se nuk është e vërtet dhe këto dy fjal dallojnë shumë, është permend në debat publik dhe Xhevati e Nënkryetari kan propozu që këto mjete të shkojnë për ndriqim publike ndërsa nuk është marrë vendim që me këto mjete të realizohet ai projekt, vetem është bërë bartja e mjeteve prej një kodit në kodin tjetër por si vendim nuk është marrë që të rregullohet ndriqimi në fshatin pasjak sikur të ish marr ai vendim sigurisht se kishte perfunduar deri më tani, ju faleminderit.

Ramush Mehmeti tha: ndoshta kam keqkuptuar unë por pas pruarjes së këtij vendimi Xhevat Mehmeti kerkon garancion që ky projekt të realizohet dhe ne si antarë të Kuvendit e kemi kuptuar se ai projekt ka perfunduar.

Pasi nuk pati diskutime tjera aprovohet procesverbali nga antarët prezent të Kuvendit me 12 vota për 1 apstenim dhe 2 nuk kanë votuar.

Pika e dytë: Aprovimi i planit Aksional për të riatdhesuarit;

Per këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën ZKKK Sami Vllasaliut.

Sami Vllasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: besoj se materialin e keni marrë të gjithë me kohë dhe keri pasur mundësi që ta shiqoni. Ju njoftoj se ky plan nuk është hartuar nga zero por është një plan i nxjerr nga Strategjia kombëtare e personave të riatdhesuar pra nuk është diqka e re po është një plan i aktiviteve. Ne deri më tani kemi bashkpunuar shumë ngusht me Ministrin e Punëve të Brendshme me departamentin për riatdhesim dhe kërkesa ka ardhur po nga ky departament pasi që është në nga kriteret që duhet të zbatohet në planin nacional për zbatimin e marrëveshjes së stabilizim asocimit apo MSA-në. Kryetari i Komunës e ka formuar një komision i cili e ka pregadit këtë plan dhe ai komision ka punuar bashkarishtë me të gjitha Komunat e Kosovës në një puntori që kemi pasur tri ditore dhe nga kjo puntori ka dal ky plan që e keni ju para vetes, për mos me zgjat më shuma kerkoj nga ju që këtë plan ta perkrahni pasi që është e nevojshme që të aprovohet pasi që është një ndër kriteret që duhet ta plotësojm të gjitha Komunat e Kosovës që është marrëveshja e stabizim asociomit që është edhe një ndër kriteret e liberalizimit të vizave, nuk po e zgjas më shumë nese knei ndonjë pyetje do të mundohem tju pergjigjem, ju faleminderit.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime me 6 vota për, 8 kunder (Nebojsa Arsic, Ramush Mehmeti, Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu, Mirjana Simijonovic, Dragana Dimic, Ivica Cenic, Milica Jovanovic) dhe 1 nuk ka votuar nuk aprovohet plani aksional për të riatdhesuarit.

Pika e tretë: Aprovimi i planit Aksional për Kthim të qëndrueshëm;

Kryesusi për këtë pikë ja dha fjalën shefes së ZKKK Jasmina Denic.

Jasmina Denic pasi pershendeti të pranishmit tha: materialin të gjithë besoj se e keni marrë me kohë, ne kemi pasur takim me Ministrin për kthim dhe ky plan ka dal nga Ministria për kthim që Komunat janë obligative që ta aprovojnë. Është obligim i yni që në bazë të urdhëreses që na ka derguar Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit, në bazë të nenit 7 të njejtës udhëres ta pregadismi këtë planin aksional për kthim. Qëllimi yn është kthimi i qëndrueshem për të kthyerit në vendin tonë. Ky plan aksional na ndihmon që të gjejm dhe kerkojm më tutje donatorë për realizimin e kthimit, me një buxhet të vogel kemi arritur që të realizojm plane të mëdha, ju lus që ta perkrahni këtë planë në mënyrë që të vazhdojm me projekte dhe të kemi mundësi në gjetjen e donatorëve të rinjë, kaq nga unë nese ka ndonjë pyetje do të mundohem tju pergjigjem, ju faleminderit.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime me 5 vota për, 9 kunder (Nebojsa Arsic, Ramush Mehmeti, Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu, Jahi Zeqiri, Mirjana Simijonovic, Dragana Dimic, Ivica Cenic, Milica Jovanovic) dhe 1 apstenim nuk aprovohet plani aksional për kthim të qëndrueshëm.

Procesverbali i Kuvendit

Pika e katërt: Prerja e Vendimit për shitjen e automjeteve të vjetra të në gjendje teknike jo të regullt, në bazë të propozimit nga komisioni për vlerësimin e gjendjes së Automjeteve të Komunës;

Kryesuesi për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Administratës Driton Abdylit.

Driton Abdylit pasi pershendeti të pranishmit tha: ashtu siç është pika në rend dite, kerkoj nga Kuvendi në bazë të një komisioni të formuar me datë 19.02.2019 i cili ka dorzuar një raport me shkrim në Drejtori për automjetet të cilat janë jasht përdorimit në bazë të ligjit për vetqeverisje lokale nenit 14 Komuna ka të drejtë që të posedoj pronë të luajtshme dhe të paluajtshme të blejë dhe të shesë ku ka konsatur se prej gjithësej 29 automjete që i posedon Komuna 10 janë të paperdoshme ku e keni marrë edhe materialin dhe janë të cekur automjetet e paperdorshme, andaj ju lus që ta perkrahni këtë vendim, ju faleminderit.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime me 5 vota për, 9 kunder (Nebojsa Arsic, Ramush Mehmeti, Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu, Jahi Zeqiri, Mirjana Simijonovic, Dragana Dimic, Ivica Cenic, Dobrivoje Djordjevic) dhe 1 apstenim nuk aprovohet vendimi për shitjen e automjeteve të vjetra në gjendje teknike jo të regullt, në bazë të propozimit nga komisioni për vlerësimin e gjendjes së Automjeteve të Komunës.

Pika e pestë: Të ndryshme.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Predrag Stojkovic pasi pershendeti të pranishmit tha: unë e kam një falenderim që e percjell nga qytetarët e fshatit Koretishtë për Kryetarin dhe të gjithë ata që janë angazhuar për funksionalizimin e ujësjellësit në fshatin Koretishtë dhe Pasjak pasi që kanë punuar intenzivisht në funksionalizimin e këtij ujësjellësi dhe qytetarët janë falenderues.

Ramush Mehmeti tha: të nderuar antarë të Kuvendit ndoshta shumë prej jush e kanë parë lajmin të shtunën në ora 7 ka qenë lajmi rreth asfaltimit të rrugës në fshatin Llabjan dhe mua më shqetëson një fakt dhe kerkoj që të sqarohet kjo pasi që në lajme u cek se një zyrtar i Komunës ka biseduar me mediat dhe ka thënë se zv.Kryesusi vet e ka propozuar projektin, vet e ka aprovuar pa lejen e Komunës dhe kjo është turp të thuhet nga Komuna pasi që e dim se askush nga Kuvendi nuk ka mundësi ta bëjë at vetëm të propozoj projekte, andaj kerkoj nga organet egzekutive të kerkojn nga KTV se kush është ai zyrtarë Komunal që e ka thënë një gjë të tillë, nese thuhet se kam propozuar e kam votuar është e vertetë se ashtu ka qenë por të thuhet se është realizuar pa perkrahjen e Komunës kjo nuk është e vertet, ju faleminderit.

Dobrivoje Djordjevic pasi pershendeti të pranishmit tha: ne banorët e fshatit Stanishor kemi pasur një takim prezent ka qenë edhe Kryesusi i Kuvendit, banorët e këtij fshati kanë kerkuar që të bëhet një zgjidhje pasi që aty qarkullojnë kamionët me peshë të madhe, përveq që e kanë dëmtuar rrugën e ndotin shumë edhe ambientin si dhe gjithashtu kanë thënë se me 28 do të protesojnë. Që dy vite kjo qështje po shtyhet prej Kuvendit në Kuvendin tjetër dhe ende nuk është bërë asnjë zgjidhje. Kryesuesi ka qenë prezen e din se çka është biseduar nese është e mundur të bëhet ndonjë zgjidhje, ju faleminderit.

Kryesusi tha: kamë qenë në takim dhe nga Kryesusi asgjë nuk është kerkuar, por është kerkuar nga organet Komonale si D.SH.P që ti vendosin disa shenja të perkufizimi të peshës së kamionëve.

Naser Ibrahim i perfaqësues i fshatit Pasjak pasi pershendeti të pranishmit tha: e falenderoj edhe unë të gjithë që kanë punuar në funksionalizimin e ujësjellësit në fshatin Pasjak dhe Koretishtë mirëpo ne në Pasjak i kemi disa shqetësime shumë të mëdha, më herët zv.Kryesusi që tha se mu ka permend emri se kanë thënë se të gjitha i ka bërë vet unë nuk e di se kush ka thënë po e perkrahi plotësisht atë person që ka thënë ashtu pasi që mua personalisht më ka thënë se i ndaj mjetet ku du unë dhe nuk është e ndershme që ky për rrugë të vet i ndaj 20,000€ e për rrugë të gjitha Pasjakit ti ndaj 5,000€. Në fshatin Pasjak ka nevoj për ndriqim, për rehabilitim të kanalizimit, ka nevoj për asfaltim të rrugëve, ndertim të trotuarëve, ka shumë kerkësa e të ndahen prej këtij Kuvendi vetëm 5,000€. Mua më ka thënë vet zv.Kryesusi se unë vet i ndaj mjetet por më vjen shumë keq prej antarëve të tjerë që po e perkrahni, të gjithë këta antarë kanë ardh këtu me vota të qytetarëve dhe kur është në pyetje interesi i qytetarëve ti lajm anash inatet politike. Është marr vendimi të rregullohet ndriqimi prapa burgut por unë nuk e di se me kënd ka biseduar a me këndë është konsultuar.

Procesverbali i Kuvendit

Jahi Zeqiri pasi pershendeti të pranishmit tha: Naser Ibrahimimi nuk është mirë me fol për nder dhe burrëni pasi që nese fillojm e folmi për nder nuk e di ku ndalemi por mirë është me qenë konkret, sa për nder që ku shihet unë jam antar i dikujt dhe antarë i qytetarëve dhe nuk është respektuar vullneti as i imi, ju faleminderit.

Kryesusi tha: ju lus që ti permbaheni pikës së rendit të dites vetem nese keni ndonjë diskutim tjetër.

Ramush Mehmeti tha: le të thotë kush dush, çka dush unë nuk po them asgjë më teper vetem se secili e ka nderin e vet, ju faleminderit.

Mirjana Simijonovic pasi pershendeti të pranishmit tha: edhe unë jam banore e fshatit Koretisht dhe shumë lehtë është që ti marrim të gjithë meritat por ka shumë familje që kanë bërë shpuarje të puseve si dhe shumë familje që kanë dhënë mjete. Por sot në shek.XXI të mbesin qytetarët pa ujë dhe në fund të falenderohemi pse kemi ujë apo rrymë. Por mendoj se koha në të cilën jetojm është jo shumë humane dhe nese duhet të falenderohemi për ujë ti falenderohmi Zotit së pari, por edhe unë po e them se banorët e fshatit Koretishtë falenderohen që kanë ujë.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: kamë një vërejtje teknike lidhur me kryesusin së pari se duhet ta dalloj asamblesitin prej një përfaqësusi të EccoHigienes apo qoftë dikujt tjetër e dyta duhet të bëhet këkesa që të mirret fjala në Kuvendin Komunal e jo të vij qoftë nga Pasjaku apo i një lagjes tjetër tna shitet se gjoja unë jam njeriu më me autoritet brenda një lokacioni se ku jeton deri sa e dim se çka kanë bërë me herët e çka janë duke bërë tash, nese hym në analiza të thella të projekteve atëher ujesjellësi në Llabjan është i bllokuar për arsye të një antari të LDK-së i cili e ka humbur kontestin në gjykatë atëher dihet se kush është fajtori nese na lihet faji se ne kemi qenë kunder ndriqimit në Pasjak atëher është shumë gabim për arsye se keni manipuluar me qytetarët dhe është edhe në procesverbal siç e tha Ramush Mehmeti më herët.

Kryesusi tha: këto diskutime nuk po na dergojn askund, nese keni diçka konkrete e mos të diskutojm diçka që ka kaluar që shumë kohë.

Xhejlane Behluli tha: o koleg i nderuar je tu fol këtu se kush ka të drejt, e din shumë mirë sjelljen që e ka bërë antari i juaj i VV këtu në mbledhje kur është zgjedh Nënkrjetar Bajrush Ymeri, a të doket e ndreshme ajo sjellje?. Ju vetem po akuzoni po akuzoni por nuk po e ktheni një pasqyre nga vetja, edhe ai nuk ka qenë antarë i Kuvendi as ai nuk ka bërë kerkesë për me marr fjalën.

Kryesusi tha: pauz 10min.

Pas pauzes 10minutshe Kryesusi tha vazhdojm nese ka dikush të shtoj edhe diçka.


Nënkrjetari për Komunitete Bajrush Ymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: vetem një sqarim, Abdyl nuk kisha pas qef me pas shumë keqkuptime, është mirë me qenë më shumë i informuar dhe kur të marsh fjalën me akuzu mos me akuzu pa fakte, unë të respektoj shumë dhe ju respektoj të gjithëve kur është diçka e vertet duhet me pranë por kur nuk është diçka e vertet është mirë mos me thënë. Shabia është e vertet që është antarë i Kryesis së LDK-së vendi është në pronën e tij si dhe është kontestuese që një kohë të gjatë pasi që kur Komuna ka ndertuar atë ujesjellës nuk e ka zgjedh atë problem sikur të ishte zgjedh nuk kishte vazhduar ky problem deri më tani sido që të jetë ai ka bërë zgjedhje pasi që ne kemi ndërmjetësuar dhe unë e kam njoftuar zyrtarin komunal Bajram Abazin e kam njoftuar edhe Kryetarin e Komunës por nuk është obligim i imi që ti vazhdoj bisedat me Hidromoraven për qështjen e ujesjellësit por është qështje e tyre por duket se dikujt nuk po i konvenon që të rregullohet ai problem dhe meqë nuk është duke i konvnuar nuk e ka inicu këtë qështje, derisa nuk është bërë zgjidhja kanë akuzuar por në momentin që është bërë zgjidhja tash shujn, prandaj unë i kam informuar që probelmi i ujesjellësit është zgjedh që disa muaj por tash vetem zyrtart komunal me Hidromoraven duhet ta funksionalizojn ujesjellësin ashtu si e kan funksionalizuar në Koretishtë, ju faleminderit.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 10:50.

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic

Kryesues i Kuvendit

